



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 748 Prot.

Tiranë, më 08 06 2018

VENDIM Nr. 114, datë 14.05.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 5, datë 14.05.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **"Projektit Hidroenergjitik të Devollit; Projektit "Linja e shpërndarjes 10kV me vendndodhje në territorin e Bashkisë Maliq"**- subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të **"Projektit Hidroenergjitik të Devollit; Projektit "Linja e shpërndarjes 10kV me vendndodhje në territorin e Bashkisë Maliq"**- subjekti "Devoll Hydropower" sh.a., realizuar nga individ i licencuar në arkeologji Z. Ylli Cerova.
2. Subjekti "Devoll Hydropower" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin "Linja e shpërndarjes 10kV me vendndodhje në territorin e Bashkisë Maliq", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë  
Tel: ++355 04 45 35 855  
email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)  
Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR  
MIRELA KUMBARO FURXHI  
MINISTRI



SEKRETAR I KKA  
RUDINA ZOTO